



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 15 janar 2013  
Nr. ref: RK339/13

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI81/12**

Parashtrues

**Hazër Susuri dhe Baki Hoxha**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,  
Pkl. nr. 88/2012, të 18 qershorit 2012**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesit e kërkesës**

1. Parashtrues të kërkesës janë z. Hazër Susuri dhe z. Baki Hoxha, me banim në Prizren.

## **Vendimet e kontestuara**

2. Aktvendimi i Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 88/2012, i 18 qershorit 2012.

## **Baza juridike**

3. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Objekti i çështjes**

4. Objekti i çështjes ka të bëjë me të drejtën e parashtruesve si paditës subsidiarë në ushtrimin e mjeteve të jashtëzakonshme juridike, përkatësisht me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

## **Procedura në Gjykatë**

5. Më 5 shtator 2012, parashtruesit dorëzuan kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 5 tetor 2012, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI-81/12, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi Gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari, me vendimin Nr. KSH. KI-81/12, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.
7. Më 1 nëntor 2012, parashtruesit u njoftuan për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, kërkesa iu komunikua Gjykatës Komunale në Gjilan dhe Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.
8. Më 6 dhjetor 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtare raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhje e fakteve siç janë dorëzuar nga parashtruesit**

9. Më 29 nëntor 2011, Gjykata Komunale në Gjilan, me Aktvendimin Ka. nr. 111/2010, në procedurë paraprake ka hedhur aktakuzën e paditësve subsidiarë (parashtruesve), me të cilën pretendohet se i akuzuari X (tani gjyqtar i Gjykatës Supreme) ka kryer veprën penale të nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore, duke shkelur kështu nenin 346 të Kodit Penal të Kosovës, sepse ka pushuar procedurën penale, me arsyetim se nuk ka prova të mjaftueshme për mbështetjen e dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale nga i akuzuari.
10. Më 19 janar 2012, Kolegji Penal i Gjykatës Komunale në Gjilan refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesve dhe përcaktoi se nuk kishte prova të mjaftueshme që mbështesin dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale të nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore nga neni 346 i KPK-së, dhe se gjyqtari i procedurës për konfirmimin e procedurës paraprake me të drejtë kishte hedhur aktakuzën e paditësve subsidiarë (parashtruesve).
11. Më 18 qershor 2012, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin Pkl. nr. 88/2010, hodhi poshtë si të palejueshme kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitur nga parashtruesit, dhe *inter alia* përcaktoi:

*“... kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e ka paraqitur personi i paautorizuar, pra paditësi subsidiar, i cili gëzon të njëjtat të drejtat të cilat i gëzon edhe Prokurori Publik, përveç atyre të cilat i takojnë Prokurorit Publik si organ i pushtetit (neni 65 par. 1 KPPK), andaj edhe e drejta e ushtrimit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë ekskluzivisht i takon Prokurorit Publik të Kosovës e jo edhe paditësit subsidiar, e për këtë arsye kërkesa si e tillë është e palejuar dhe hedhet poshtë, sepse është ushtruar nga personi i paautorizuar”.*

*“Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të të gjykuarit i është përgjigjur Prokurori Publik i Kosovës me parashtrësën KMLP. II. nr. 91/12, e 12 qershorit 2012, me propozim që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të hidhet si e papranueshme ngase është paraqitur nga personi i paautorizuar”.*

### **Pretendimet e parashtruesve**

#### **12. Parashtruesit kërkojnë nga Gjykata:**

- a) që kërkesën e tyre ta shpallë të pranueshme;
- b) të shpallë të pavlefshëm, kundërkushtetues, Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Pkl. Nr. 88/2010, e 18 qershorit 2012, sepse është në kundërshtim, shkelje të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, duke iu shkurtuar parashtruesve të drejtën për mjete juridike, përkatësisht shkurtimin e të drejtës në ushtrimin e mjeteve të jashtëzakonshme juridike, kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë ndaj Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Gjilan, KA. nr. 111/2010, të 29 nëntorit 2011, si dhe në shkelje të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, ngase parashtruesve nuk u është lejuar e drejta në shfrytëzim të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, që parashtruesit, në cilësinë e paditësve subsidiarë, i gëzojnë në rastet kur Prokurori Publik nuk iniciuon ndjekjen penale;
- c) të lejohet si e ligjshme dhe kushtetuese kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, e paraqitur nga parashtruesit kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Gjilan, KA. nr. 111/2010, të 29 nëntorit 2011;
- d) Parashtruesit po ashtu theksojnë:

*“... në bazë të rregullit 63 (5) të Rregullores së punës, Gjykata Supreme e Kosovës në Prishtinë detyrohet t'i dorëzojë informacione Gjykatës Kushtetuese për masat e ndërmarra në zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese”.*

13. Përfundimisht, parashtruesit pretendojnë se, bazuar në nenin 65.1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPK), si paditës subsidiarë, i gëzojnë të njëjtat të drejta që i gëzon Prokurori Publik për të paraqitur kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Parashtruesit, po ashtu, pretendojnë se neni 452.1 i KPPK-së përcakton Prokurorin Publik si subjekt për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, mirëpo, në këtë rast, funksionet e Prokurorit Publik janë bartur *ex lege* te parashtruesit, sepse Prokurori Publik ka hequr dorë nga ndjekja penale dhe se, gjithashtu, gjatë procedurës së padisë subsisiare nuk ka iniciuar ndjekjen penale.

### **Dispozitat relevante ligjore**

#### **14. Neni 65 i KPPK-së përcakton:**

*“(1) Paditësi subsidiar gëzon të njëjtat të drejta të cilat i gëzon edhe prokurori publik, përveç atyre të cilat i takojnë prokurorit publik si organ i pushtetit”.*



*“(2) Në procedurën e cila zbatohet në bazë të kërkesës së paditësit subsidiar, prokurori publik ka të drejtë që deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të ndërmarrë ndjekjen dhe të mbrojtje akuzën”.*

15. Neni 443, paragrafi 1, i KPPK-së përcakton:

*“(1) Rishikimin e procedurës penale mund ta kërkojnë palët dhe mbrojtësi. Pas vdekjes së të dënuarit, rishikimin mund ta kërkojë prokurori publik, bashkëshorti, bashkëshorti jashtëmartesor, farefisi në vijë direkte deri në shkallë të parë, prindi adoptues, fëmija i adoptuar, vëllai, motra ose prindi birësues i të dënuarit”.*

16. Neni 452, paragrafi 1, i KPPK-së përcakton:

*“(1) Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqesë prokurori publik i Kosovës, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Pas vdekjes së të pandehurit kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të tij mund të paraqesin personat e paraparë në nenin 443, paragrafi 1, fjalia e fundit e këtij Kodi”.*

#### **Vlerësim i pranueshmërisë së kërkesës**

17. Për të gjykuar kërkesën e parashtruesve, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse janë përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.

18. Neni 113.7 i Kushtetutës përcakton:

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

19. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesit kanë parashtruar ankesa dhe kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në dy shkallë të pushtetit të rregullt gjyqësor, përkatësisht në Gjykatën Komunale në Gjilan dhe në Kolegjin Penal të së njëjtës, si dhe në Gjykatën Supreme të Kosovës dhe, rrjedhimisht, kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës.
20. Bazuar në shkesrat e kërkesës, Gjykata vëren se konkludimet e Gjykatës Supreme janë të qarta dhe se ekziston lidhja logjike ndërmjet bazës juridike dhe arsyetimit të dhënë, gjë që tregon se vendimi i Gjykatës Supreme nuk është karakterizuar me padrejtësi ose me arbitraritet.
21. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata Supreme, përveç të tjerash, ka marrë për bazë edhe propozimin e Prokurorit Publik që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, e paraqitur nga parashtruesit në cilësi të paditësve subsidiarë, duhet të hedhet poshtë si e palejueshme, ngase është paraqitur nga persona të paautorizuar.
22. Gjykata ua përkujton parashtruesve se dispozitat përkatëse të KPPK-së, në të vërtetë, u lejojnë diskrecion Prokurorit Publik dhe Gjykatës Supreme të konkludojnë ashtu siç kanë konkluduar në rastin konkret.
23. Gjykata, po ashtu, ua përkujton parashtruesve se ka detyrim kushtetues që të respektojë parimin e ndarjes së pushteteve, të pavarësisë së organeve të pushtetit shtetëror të garantuar me Kushtetutë dhe të kontrollit e balancit ndërmjet tyre, ndërsa veprimi ndryshe do të ishte në kundërshtim me parimin e përmendur dhe, rrjedhimisht, kundërkushtetues.
24. Gjykata në mënyrë të ngjashme ka konkluduar më 12 dhjetor 2011 në Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI92/11, parashtrues Muhamet Bucaliu – Vlerësim i

kushtetushmërisë së Njoftimit të Prokurorit të Shtetit, KMLC. Nr. 37/11, të 2 qershorit 2011.

25. Përkitazi me këtë, parashtruesit e kërkesës nuk i kanë mbështetur pretendimet e tyre, duke shpjeguar se si dhe pse është kryer ndonjë shkelje, ose duke ofruar dëshmi për të vërtetuar se u është shkelur ndonjë e drejtë e garantuar me Kushtetutë.
26. Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e gjetjes të fakteve dhe, me këtë rast, thekson se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i saj është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore, prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (*Shih, mutatis mutandis, i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R. J. D, 1996-IV, para. 65.; gjithashtu shih edhe Aktvendimin për papranueshmëri në rastin Nr. KI86/11, parashtrues i kërkesës Milaim Berisha, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 20/09, të datës 1 mars 2011, marrë nga Gjykata, më 5 prill 2012*).
27. Për më tepër, kërkesa nuk tregon se Gjykata Supreme ka vepruar në mënyrë arbitrare apo në mënyrë të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të zëvendësojë vlerësimin e saj të fakteve me ato të gjykatave të rregullta. Si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave të vlerësojnë dëshmitë para vetes. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë ato dëshmi, (*Shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, App. Nr 13071/87, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, paragrafi 3, e 10 korrikut 1991*).
28. Fakti se parashtruesit nuk pajtohen me rezultatin e rastit, nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë që të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të neneve 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës (*Shih, mutatis mutandis, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, Appl. nr. 5503/02, MezturTiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005*).
29. Në këto rrethana, parashtruesit nuk kanë mbështetur me prova pretendimet e tyre, e as shkeljet e nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, sepse faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk tregojnë se gjykatat e rregullta të tri instancave ua kanë mohuar atyre të drejtat e garantuara me Kushtetutë.
30. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të hedhet poshtë si e papranueshme, në pajtueshmëri me rregullin 36 të Rregullores së punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 20 të Ligjit, si dhe në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 6 dhjetor 2012, njëzëri:

### VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Arta Rama-Hajrizi



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani